



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26-38/2018 regjistër (JR)
Datë 24.02.2023

Nr. 20 i vendimit
Datë 15.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.05.2025, ditën e enjte, në orën 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

KËRKUES: Ahmet Jangulli, lindur më {***}, dhe banues në rrugën “{***}”, Tiranë.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, prishjen e tij, gjykimin e çështjes, shfuqizimin e vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë.

BAZA LIGJORE: Kodi i Procedurës Civile, nenet 1, paragrafi i dytë, 2, 5, 6, 7 e vijues, 14, 16 e vijues, 28 e vijues, 32 gjerat “a” dhe “b”, 47, 53, 54, 310, 311, 317, 442 e vijues, 494 e vijues, 510 dhe 511 të tij; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenet 1, 2, 3, 7, 10, 15, 16, 17, 18, 28, 35, 37, 40, 41, 44 e vijues të tij.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit Ahmet Jangulli në kërkesat e paraqitura prej tij dhe parashtrimet me shkrim, i cili ka kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Ahmet Jangulli (në vijim kërkuari) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 67, datë 05.10.2018, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ahmet Jangulli. Këtë vendim kërkuari e ankmoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili me vendimin nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, vendosi lënien në fuqi të tij.
2. Në vendimin nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, trupi gjykues i Kolegji ka vendosur se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 67, datë 05.10.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi, pasi subjekti i rivlerësimit Ahmet Jangulli gjendet në kushtet e neneve D, pikat 1, 3 e 5 dhe E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kërkuari ka paraqitur në Kolegj dy kërkesa për rishikimin e vendimit të cituar më lart. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim trupi gjykues), i ngarkuar me short për shqyrtimin e kërkesës së parë të regjistruar në Kolegj më datë 24.02.2023, me vendim të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 29.04.2025, në zbatim të nenit 448 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi bashkimin e dy kërkesave të paraqitura prej tij për rishikimin e vendimit nr. 30/2019, datë 18.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kërkesën me nr. 270 prot., datë 24.02.2023 dhe kërkesën me nr. 47/4 prot., datë 18.12.2024, për t’i gjykuar në një proces të vetëm, në kuadër të çështjes nr. 26-38/2018, datë 24.02.2023.

Në kërkesat për rishikimin e vendimit të Kolegjit, kërkuari parashtron në mënyrë të përmbledhur si vijon:

3.1 Kërkesa nr. 1 – Kërkuari sjell në vëmendje se më datë 04.10.2022, GjEDNJ-ja ka dhënë vendimin për çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, në të cilën ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtën e kërkuarit (B. C.) për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Kërkuari pretendon se, duke qenë se ky vlerësim ishte unanim, duke konstatuar se në vendimin e Kolegjit nr. 30/2019 (JR) ekziston e njëjta problematikë, prezenca në përbërje të trupit gjykues e gjyqtarit L. D., me cilësinë e kryesuesit, vlerëson se Kolegji është i detyruar për rihapjen e procedurave civile dhe kushtetuese ndaj tij, sepse Kolegji nuk mund të mbajë dy standarde për të njëjtën gjë. Kërkuari

vlerëson se duke qenë se mbi të njëjtat rrethana faktike, mund të vijë nga GjEDNj-ja një vlerësim i ngjashëm me çështjen e Canit kundër Shqipërisë, kërkon nga Kolegji alternativën e rihapjes së procedurave edhe për rastin e tij.

3.2 Për gjykimin në themel, kërkuesi pretendon t'i konsiderohen kërkimet e parashtruara në ankimin e datës 15.10.2018, në shpjegimet e datës 07.12.2018 dhe në shpjegimet nr. 2 dhe nr. 3 të datës 01.11.2019, për aktet që nuk kishte njohur Komisioni dhe për procesin e zhvilluar nga Komisioni.

3.3 Për sa më sipër, kërkuesi pretendon të hapet një seancë gjyqësore publike, të gjykohet kërkesa e tij e më pas Kolegji të vendosë:

- Pranimin e kërkesës për rishikim dhe prishjen e vendimit nr. 30 (JR), datë 18.11.2019, të Kolegjit, duke vazhduar gjykimin në themel.
- Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e vendimit nr. 67, datë 05.10.2018, të Komisionit.
- Vlerësimin e aftësive dhe konfirmimin në detyrë si gjyqtar administrativ i Shkallës së Parë Shkodër, duke zgjidhur edhe pasojat juridike/të drejtat e cenuara.

3.4 Kërkesa nr. 2 – Kërkuesi shpjegon se ka vlerësim të ndryshëm nga ai që ka mbajtur trupi gjykues i Kolegjit në çështjen që i përket kërkesës për rishikim të paraqitur nga A. Y., duke sqaruar se Kolegji ka juridiksion rishikues për të gjitha rrethanat e parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile. Kërkuesi shpjegon se një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë* në paragrafin 46 të vendimit, si dhe në paragrafin 111 të tij ku citohet: *Kërkuësja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L. D., për pozicionin e tij, një kërkesë për rishikim përjashtimor në vendimin e formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj, mbështetur në faktet e zbuluara rishtazi apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile [...].*

Kërkuesi sqaron se Kolegji, në vendimin nr. 12, datë 17.04.2024 [që i përket kërkuetit A. Y.], qartësisht pranon juridiksionin rishikues, por ai duhet të vijë vetëm nëpërmjet vendimeve të GjEDNj-së, gjë e cila nuk përputhet me vetë orientimin që jep GjEDNj-ja për të shfrytëzuar mundësitë përjashtimore.

3.5 Kërkuesi pretendon se është vënë në dijeni për fakte të reja, të zbuluara rishtazi, se anëtar i trupit gjykues A. H., që ka gjykuar çështjen e tij të rivlerësimit në Kolegji, më datë 18.11.2024, është dënuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke e shpallur fajtor. Kërkuesi parashtron se në dënimin penal, lehtësisht provohet mungesë e kushteve dhe kriterëve ligjore për t'u përzgjedhur dhe emëruar pranë KPA-së, dhe ky përbën një fakt të zbuluar rishtazi dhe të dhënë të re e vendimtare, çka e bën atë shkak për rishikimin e vendimit të Kolegjit që i përket çështjes së tij të rivlerësimit.

3.6 Në përfundim të kërkesës së dytë për rishikim, kërkuesi për të gjitha sa parashtron, kërkon të hapet një seancë gjyqësore publike, në të cilën të vendoset pranimi i kërkesës për rishikim vendimi të formës së prerë, prishjen e vendimit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, të Kolegjit për t'i hapur rrugë gjykimit në themel, duke: a) dërguar çështjen në Gjykatë Kushtetuese për shqyrtim ndaj meritës; dhe b) nëse Kolegji do të vijojë si në praktikat e mëparshme, ta dërgojë

paraprakisht çështjen në Gjykatën Evropiane ose në Komisionin e Venecias (për mendim këshillimor).

3.7 Kërkuesi ka paraqitur në vazhdimësi në Kolegj, përgjatë fazës që çështja ishte me statusin në studim e përgatitje, parashtrime lidhur me pretendimet e tij të paraqitura në kërkesat për rishikim dhe kërkesa për njohje me aktet e dosjes së krijuar në Kolegj, të cilat i janë vënë në dispozicion. Gjithashtu kërkuesi ka paraqitur më datë 22.04.2025, tri kërkesa për përjashtimin e tre anëtarëve të trupit gjykues që do të gjykonte kërkesën e tij për rishikimin e vendimit të Kolegjit, kërkesa të cilat janë shqyrtuar paraprakisht nga trupat gjykues përkatës, duke vendosur në mënyrë të njëjtë, mospranimin e këtyre kërkesave. Në vijim, pas njohjes me këto vendime të Kolegjit, kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimeve të mospranimit të kërkesave të tij për përjashtimin e tre anëtarëve të trupit gjykues, ndonëse këto vendime janë të paankimueshme në mënyrë të veçantë dhe marrin formë të prerë në kuptim të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

4. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Në vijim të sa më sipër, i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.

5. Kolegji, në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që u përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y., ka arritur në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Më tej ka arsyetuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplisit për ushtrimin e

juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuetit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016, nëse nëpërmjet tyre mund të ushtrohej ky juridiksion rishikues i pretenduar nga kërkueti.

6. Në vijim të sa më sipër, në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Në vendimin e cituar në paragrafin më sipër, është marrë në analizë nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret, lidhur me tagrat e atribuuar organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, në vendimin e referuar më sipër, por edhe në vendimet e marra më pas që kanë shqyrtuar kërkesa të ngjashme për rishikimin e vendimeve të Kolegjit¹, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
7. Në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa “b” e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëjnë pjesë në aktet normative që kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku me mekanizmat e saj zbatues, garanton zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenet 17 e 42 të Kushtetutës. Parashikimi i nenit F, pika 8² e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit, është në shkelje të parashikimeve të konventës dhe protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që edhe Shqipëria është palë.
8. Në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në germën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*

¹ Vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.02.2025; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025; vendimi nr. 18, datë 08.05.2025; vendimi nr. 19, datë 08.05.2025.

² Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNj-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, po ashtu edhe gjykatat me juridiksion specifik, siç është Kolegji. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jovendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 germat e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

9. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuarit Ahmet Jangulli, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim, ndaj kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuari bën në nenin 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile. Sipas analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës³ së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
10. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislati brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative, të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
11. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuarit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsyetimit të mësipërm, sërish ato, të

³ Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, që u përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y.; vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit A. B.; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit B. M..

vlerësuar sipas parimit *obiter dictum*, konstatohen se janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste⁴ të ngjashme, dhe do të vlerësoheshin njësoj si të pabazuara edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor. Në kushtet që vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D., rezulton të jetë kryer vite përpara vendimit objekt rishikimi dhe nuk ekziston asnjë lidhje shkakësore në raport me të, nuk mund të argumentohet se gjen zbatim neni 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera⁵. Për më tepër, lidhur me anëtarin tjetër të trupit gjykues A. H., nuk ka ende një vendim përfundimtar për çështjen penale mbi të cilën z. Jangulli ka mbështetur kërkesën e dytë për rishikim.

12. Lidhur me pretendimin se dy gjyqtarët, A. Sh. dhe S. Ç., pjesë përbërëse e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e tij të rivlerësimit, në cilësinë e anëtarëve të ish-KLD-së, kanë marrë pjesë në procedimin disiplinor të ngritur në vitin 2015 ndaj kërkuarit, si dhe kanë votuar pro vendosjes së masës disiplinore, rezulton të jetë një pretendim i ngritur për herë të parë vetëm në kuadër të kërkesës për rishikim, dhe nuk evidentohet që kërkuari të ketë ngritur këtë pretendim më parë në Kolegj, gjatë shqyrtimit të çështjes së tij të rivlerësimit. Parë në këtë këndvështrim, për sa kohë, edhe në abstragim të çdo analize të bërë më lart, shkaqet e rishikimit në thelb synojnë të ndreqin një gabim gjyqësor që ka ndodhur për shkaqe të panjohura për palët ndërgjyqëse apo gjykatën, mosparaqitja e këtyre pretendimeve në kohën e gjykimit të çështjes, me gjithë prezumimin e dijenisë së plotë të kërkuarit për qenien e tyre si anëtarë të KLD-së, për shkak të një informacioni publik dhe të mirënjohur prej magjistratëve në detyrë, e ka shuar në mënyrë përfundimtare të drejtën e tij për ngritjen e pretendimeve të tilla nëpërmjet një mjeti të jashtëzakonshëm ankimi, përndryshe e gjithë siguria juridike e garantuar me Kushtetutë e me ligj, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, do të ishte në rrezik.
13. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur prej kërkuarit Ahmet Jangulli nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, si dhe nr. 4, datë 15.02.2024.

⁵ Shih për referencë vendimin që i përket kërkesës së znj. R. G.: https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf, si dhe vendimin që i përket kërkesës së znj. A. G.: https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Ana_Golloshi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar-1-rishikim.pdf.

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesave të kërkuarit Ahmet Jangulli, me nr. 270 prot., datë 24.02.2023 dhe nr. 47/4 prot., datë 18.12.2024, me objekt rishikimin e vendimit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.05.2025.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 20 (JR), datë 15.05.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *Mospranimin e kërkesave të kërkuarit Ahmet Jangulli, me nr. 270 prot., datë 24.02.2023 dhe nr. 47/4 prot., datë 18.12.2024, me objekt rishikimin e vendimit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*, por me një arsyetim ndryshe, lidhur me arsyet se përse këto kërkesa për rishikim nuk duhen pranuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Siç shihet edhe nga arsyetimi i shumicës në vendim, është përdorur e njëjta linjë arsyetimi në lidhje dhe me çështjet e tjera që u përkasin kërkesave për rishikim të vendimeve të juridiksionit të rivlerësimit. Më konkretisht, jam kundër arsyetimit të shumicës [...] *për t'i dhënë përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuarit Ahmet Jangulli, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim, ndaj kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuari bën në nenin 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile. Sipas analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së [...].*
3. Unë, gjyqtarja me mendim paralel, vlerësoj se në kushtet kur Kushtetuta dhe ligji nuk i ka atribuar Kolegjit juridiksion rishikues, ndaj mendimin se ky institucion nuk mund të ushtrojë këtë tagër/rishikim ndaj vendimeve të tij, kështu që mbetet detyrë pikërisht e ligjvënësit, në kuadër të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke rishikuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore, duke përcaktuar gjykatën kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes me vendimin nr. 20 (JR), datë 15.05.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesave të kërkuarit Ahmet Jangulli, me nr. 270 prot., datë 24.02.2023 dhe nr. 47/4 prot., datë 18.12.2024, për rishikimin e vendimit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se *Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.*
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuarisi A. Y.⁶, si dhe në mendimin e pakicës për kërkesën e kërkuarit B. M.⁷.
4. Sa u përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në të dyja kërkesat e z. Ahmet Jangulli, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafin 11 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, si dhe duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁶ Shih mendimin paralel në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf.

⁷ Shih mendimin e pakicës në vendimin nr. 10, datë 28.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: https://kpa.al/wp-content/uploads/2025/05/Vendim-rishikimi-JR-Bilbil-Mete_p%C3%ABrfshir%C3%AB-mendimin-paralel-dhe-mendimin-e-pakic%C3%ABs_anonimizuar.pdf.